



BPrAL - PPOHE  
**Kolegji AAB**

**DEGA - GJAKOVË**

***DREJTIMI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË  
& MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI***

**Lënda:**

**INFORMATIKA E BIZNESIT**

**Mësimdhënësi**

***MSc.Florent Bunjaku, PhD cand.***

**Viti akademik 2014/2015**

# HYRJE NË INFORMATIKËN E BIZNESIT

## INFORMATIKA

- **L'INFORMATIQUE=L'INFORmation+L'autoMATIQUE**  
(Filip Drejfus në vitin 1962)  
përkatsisht:
- **INFORMATIKA=INFORmata + autoMATIKA**  
burime të tjera si:  
**INFORMATIKA = INFORMATION + MATEMATIK**

# Ç'ËSHTE INFORMATIKA?

**Informatika është shkencë e cila bënë mbledhjen, përpunimin, depozitimin, bartjen (transmetimin) dhe shfrytëzimin e të dhënave/informatave me ndihmën e pajisjeve teknike për përpunimin e të dhënave në kuadër të sistemit të caktuar informativ.**

**Historikisht informatika si shkencë është zhvilluar nga matematika kurse zhvillimi i sistemeve të para llogaritare zanafillën e kanë në elektroteknikë dhe teknikën e informacionit.**

**Sidoqoftë kompjuterët, paraqesin vetëm një medium të informatikës për zbatim praktik të koncepteve teorike.**

# RËNDËSIA E INFORMATIKËS

- **Informatika pothuajse të gjitha sferat e jetës moderne i ka mbuluar, dhe posaqërisht kjo është mundësuar nëpërmjet ndikimit enormë të **Internetit**. Lidhja në rrjeta të ndryshme lokale dhe posaqërisht ato internacionale solli revolucion në telekomunikacion dhe në përpunimin e të dhënave/informatave në ndërmarrje, në Logjistikë, media por edhe në amvisritë private.**

# DEGËT/ DISIPLINAT E INFORMATIKËS

**Informatika ndahet në sfera apo fusha dhe atë në:**

- 1. Informatikën teorike**
- 2. Informatikën praktike**
- 3. Informatikën teknike**

**Informatika teorike** - ka të bëjë në rend të parë me aspekte të ndryshme të Algoritmeve dhe mundë të trajtohet si bazë për disiplinat tjera të informatikës.

- **Informatika praktike** – ka të bëjë me zgjidhjen e problemeve konkrete të informatikës dhe posqërisht me zhvillimin e programeve kompjuterike në të ashtuquajturën teknikën softverike.
- **Informatika teknike** - merret me aspektet apo bazat **Hardverike** të Informatikës si psh. Arkitektura e kompjutorëve, teknikën e mikroprocesorëve, sistemet e shpërndara etj. dhe paraqet lidhje (*connecting link*) me Elektroteknikën.

# **TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT**

## **INFORMATION AND COMMUNICATION TECHNOLOGIES (ICT)**

- **Paraqet term gjenerik (të përgjithshëm) i cili përfshinë të gjitha mjetet teknike për përpunimin e informacionit dhe komunikimit.**
- **ICT përcakton një gamë të gjerë të teknologjive, duke përfshirë metodat për komunikim (protokollet e komunikimit, teknikat e transmetimit, pajisjet e komunikimit, mediat), si dhe teknikat për memorim dhe përpunimin e informacionit.**



- Termi **Teknologji** (nga greqishtja = τεχνολογία)  
- Dituria që ka të bëjë me prodhimin ose/dhe përpunimin e që fillimisht nënkuptonte diturinë apo shkencën e një teknike.
- Në përdorim bashkëkohore, termi - **Teknologji** shpesh përdoret si sinonim për **Teknikë**.
- Termi **Teknikë** paraqet një metodë apo mënyrë që do të përdoret për të arritur një rezultat të veçantë.
- Termi **Teknologji** paraqet njohjen e kësaj **Teknike** (Si funksionon ajo? Cilat janë përvojat, rreziqet dhe mundësitë që i ofron ajo).

**Në “Information Technology Association of America (ITAA)” është definuar si:**

**“the study, design, development, implementation, support or management of computer-based information systems, particularly software applications and computer hardware”**

**TI- ka të bëjë me shfrytëzimin e kompjuterëve dhe softverin e kompjuterëve për konvertimin, ruajtjen, memorimin, procesimin, bartjen dhe rikthimin e sigurtë të informatave.**

# AFARIZMI DHE INFORMATIKA

**Në kushtet bashkohore të zhvillimit të afarizmit, informata paraqet resurs të rëndësishëm në ndërmarje, kurse teknologjia informatike faktorë shumë të rëndësishëm për suksesin dhe efikasitetin e afarizmit të sajë.**



# INFORMATIKA E BIZNESIT

- **Informatika e Biznesit është një disiplinë në zhvillim e sipër që kombinon aspekte të ndryshme të Menaxhimit të Biznesit, të Teknologjisë së Informacionit, dhe Informatikës.**
- **Qëllimi i Informatikës së Biznesit është që të integroj shkencat kompjuterike dhe administrimin e biznesit në një fushë.**

- Puna e organizuar e njeriut quhet **BIZNES** (afarizëm), kurse
- Bashkimi i individëve ose i personave të lidhur njëri me tjetrin gjatë kryerjes së aktivitetit të caktuar afarist formon **SUBJEKTIN AFARIST**
- Subjektet afariste janë sisteme me të cilat duhet menaxhuar kurse një nga komponentet më të rëndësishme të menaxhimit me sisteme është këmbimi i informatave, respektivisht **KOMUNIKIMI**
- Komunikimi mbrenda subjekteve afariste dhe midis disa subjekteve afariste mundësohet në saje të **INFORMATIKËS SË BIZNESIT**

**Informatika e Biznesit (BI)** është një disiplinë që kombinon **Teknologjinë e Informacionit (IT)**, **Informatikën** dhe **Konceptet e Menaxhimit**.

**Disiplina e Informatikës së Biznesit u krijua në Gjermani, nga koncepti **Wirtschaftsinformatik**.**

**Ajo është themeluar, si një disiplinë e suksesshme akademike, duke përfshirë, programet bachelor, master dhe programet e diplomave në Austri, Bullgari, Francë, Gjermani, Irlandë, Hollandë, Zvicër dhe në një numër në rritje të vendeve të tjera evropiane, si dhe në Australi.**

# KLASIFIKIMI I PROFESIONEVE TË INFORMATIKËS

- **Prodhuesit e informatave (shkenctarët, hulumtuesit etj.)**
- **Përpunuesit e informatave (Programerët, projektuesit, specialistët)**
- **Shpërnadrësit e informatave (organizatat distributive të informatave)**
- **Punëtorët e infrastrukturës (sigurimin e kushteve për punë)**

# QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË INFORMACIONEVE

- **Racionalizimi apo kursimet e shpenzimeve**
- **Trajtimin e sasive të mëdha të të dhënave**
- **Përhshpejtimin e proceseve biznesore**
- **Përmirësimi i cilësisë dhe i shërbimeve**
- **Mbështetje të Planifikimit, Menaxhimit dhe Kontrollit - Llogaritje të gjëra (Extensive) dhe të komplikuar**
- **Mundësimi i formave të reja të organizimit.**



# PËRKUFIZIMI I SHKENCËS SË KIBERNETIKËS SI DHE OBJEKTI, QËLLIMI DHE METODA E KIBERNETIKËS

- **Kibernetika është teori e komunikimit dhe e proceseve të qeverisjes dhe rregullimit të makinave dhe organizmave të gjallë. (Norbert Winer) Kibernetika shkencë mbi qeverisjen, udhëheqjen dhe rregullimin. Kibernetika është shkencë mbi qeverisjen e proceseve të të gjitha llojeve.**

**Winer-i** i pari jep përgjigje në pyetjet:

- a) Me çka menaxhohet – me sisteme
- b) Me ndihmën e kujt menaxhohet – me informata
- c) Si menaxhohet – me procese

- **Objekt i studimit të kibernetikës janë sistemet e ndërlikuara **dinamike**.**
- **Qëllimi dhe detyrë e Kibernetikës është zbulimi i metodave dhe parimeve të përgjithshme si dhe metodave sa më efikase për qeverisjen dhe rregullimin e sistemeve dinamike.**
- **Metoda e studimit të Kibernetikës është **Teoria e Përgjithshme e Sistemeve**.**

# FAKTORËT NDIKUES NË FORMIMIN E SHKENCAVE DHE KIBERNETIKA

**Zhvillimi i mendimit shkencor ka kaluar nëpër disa etapa.**

**Etapat karaktereizohen me metodat të cilat kanë mbizotruar në aktivitetet kërkimore shkencore.**

**Siç janë:**

- 1. Etapa e parë – (vrojtuese-përshkruese)**
- 2. Etapa e dytë – (analitike)**
- 3. Etapa e tretë – (sistimore)**

**Etapa e parë** – paraqet fazën fillestare të zhvillimit të shkencës në të cilën mbretërojnë **vrojtimi dhe përshkrimi i dukurive.**

**Objekti i studimit shqyrtohet globalisht, pa hyrë shumë në analizën e thellë dhe zbërthimin e tij.**

**Për këtë etapë janë karakteristike shkencat me objekt global studimi siç janë:**


- **Filozofia dhe**
- **Matematika**

*Shembull: Ndërrimi i ditës dhe natës, Rënia e trupit në tokë nën ndikimin e gravitacionit etj.*

## Etapa e dytë – vend parësor zë metoda analitike

- Sipas kësaj metode të kërkimeve shkencore objekti i studimit zërthehet në pjesët e tij përbërëse dhe secila pjesë shqyrtohet veç e veç dhe në marrëdhënie me pjesët e tjera të tërësisë.
- Me këtë metodë bëhet përshkrimi i hollësishëm i strukturës së objektit të studimit.
- Metoda analitike kalon nëpër disa faza: **Definimi, Analiza, Hulumtimi, Krijimi i relacioneve dhe Shpjegimi**




*Shembull: Paraqitja e reve mund të bjerë shiun, ... Rezultati i gjuajtjes së zarit etj.*




*Hulumtimi i fenomeneve sipas qasjes analitike*

## Etapa e tretë – metoda sistemore

- Sipas kësaj metode dukuritë mund të studiohen dhe kuptohen me sukses vetëm nëse trajtohen si tërësi, respektivisht si sistem.
- Çdo studim i veçuar i komponenteve të tyre mund të ndikoj negativisht në humbjen e karakterit kompleks të tyre.
- Kjo metodë ka rëndësi sidomos për dukuritë dhe sistemet e ndërlikuara.



*Rrjeti i interakcionit*



*Hulumtimi i fenomeneve sipas qasjes sistemore*



- **Kibernetika** bazohet në **metodën sistemore** dhe poashtu ndikoi që kjo metodë të zbatohet edhe në shkencat tjera.
- Pra zhvillimi i mendimit shkencor e me këtë edhe formimi i shkencave ka qenë i ndikuar prej dy faktorëve vendimtar:
  1. **Faktori i veçimit dhe**
  2. **Faktori i përgjithësimit.**

- Në saje të **faktorit të veçimit** krijohen disiplina të veçanta shkencore me metoda specifike për probleme të caktuara.
- **Faktori i përgjithsimit** ka të bëjë me krijimin e shkencave të cilat paraqesin një sintezë të rezultateve të disa shkencave (si psh. kibernetika) për t'i studiuar dukuritë në tërë kompleksitetin e tyre.
- **Faktori i përgjithsimit** i përgjigjet **metodave sistemore**.

# TEORIA E PËRGJITHSHME E SISTEMEVE SI METODË E KIBERNETIKËS (TPS)

- Teoria e Përgjithshme e Sistemeve i ndërlidhë dhe i gjeneralizon njohuritë nga shkencat e ndryshme.
- Në këtë mënyrë ajo jep bazën dhe konceptin e përbashkët për studimin e sistemeve të ndërlikuara dinamike, duke sqaruar konceptet që kanë të bëjnë me formimin, organizimin, zhvillimin dhe qeverisjen e tyre.
- Kjo e përbën objektin e studimit të Teorisë së Përgjithshme të Sistemeve.